



**Republika e Kosovës**

Republika Kosova-Republic of Kosovo

**Qeveria –Vlada-Government**

**Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK)**

Univerziteteska Bolnička i Klinička Služba Kosova (UBKSK)

Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)

**Rregullore Nr. 998/2016  
për Pushimet**

**Kjo Rregullore do të zbtohet në të gjitha njësitë përbërëse organizative të SHSKUK-së**

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të Statutit të Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës, nenit 45 pika 3 të Ligjit të Shëndetësisë së Kosovës nr.04/L-125, nenit 95 të Ligjit të punës nr. 03/L-212, Bordi Drejtues i SHSKUK-së në mbledhjen e mbajtur me: **08.08.2016** miraton këtë:

## **RREGULLORE PËR PUSHIMET**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

Kjo Rregullore përcakton rregullat dhe procedurat unike për shfrytëzimin e pushimeve të punonjësit në institucionet shëndetësore publike të nivelit dytësor dhe tretësor si njësi organizative të SHSKUK-së në Republikën së Kosovës, në pajtim me Ligjin e Punës.

### **Neni 2**

#### **Fushëveprimi**

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen në të gjitha institucionet shëndetësore publike të nivelit dytësor dhe tretësor si njësi organizative të SHSKUK-së të Republikës së Kosovës, me rastin e shfrytëzimit të pushimit vjetor dhe të pushimeve të veçanta të punonjësve në institucionet shëndetësore.

### **Neni 3**

#### **Përkufizimet**

Përkufizimet, të cilat janë përdorur në Ligjin e Punës nr. 03/L-212, vlejnë edhe për këtë Rregullore.

### **Neni 4**

#### **Pushimi gjatë orarit të punës**

1. Punonjësi ka të drejtë për pushim gjatë ditës së punës, me orar të plotë të pandërprerë të punës, në kohëzgjatje (1) një orë, i cili nuk mund të caktohet në fillim apo në mbarim të kohës së punës.
2. Në qoftë se natyra e punës nuk lejon që puna të ndërpritet, organizimi i pushimit gjatë ditës së punës bëhet në mënyrë që të mos shkaktohet ndërprerja e procesit të punës.
3. Secilës grua të punësuar që ushqen foshnjën me qumësht gjiri i takojnë të gjitha të drejtat e garantuara me legjislacionin përkatës në fuqi në Kosovë.
4. Çdo e punësuar që ushqen foshnjën me qumësht gjiri, nëse nuk e shfrytëzon pushimin e lehonisë pas muajit të gjashtë të tij dhe sipas dispozitave përkatëse ligjore në fuqi, prej muajit të gjashtë (6) deri në një (1) vit ka të drejtën e pushimit me pagesë në kohëzgjatje prej dy (2) orë në ditë brenda orarit të punës, duke mos përfshirë pushimin e rregullt gjatë orarit të punës, për ta ushqyer foshnjën me qumësht gjiri, siç është përcaktuar me legjislacionin në fuqi.
5. Çdo e punësuar që ushqen foshnjën me qumësht gjiri pas vitit të parë deri në dy (2) vjet ka të drejtën e një (1) orë në ditë pushim me pagesë brenda orarit të punës, për ta

ushqyer foshnjën me qumësht gjiri, duke mos përfshirë pushimin e rregullt gjatë orarit të punës.

6. Çdo e punësuar që ushqen foshnjën me qumësht gjiri, pushimin me pagesë në kohëzgjatje prej (1) një apo dy (2) orë në ditë brenda orarit të punës, e shfrytëzon në fillim , në mes, apo përfundim të orarit të punës, në marrëveshje me punëdhënësin dhe për këtë e njofton me shkrim punëdhënësin bashkë me vërtetimin e mjekut se e punësuar është në gjidhënje.

#### **Neni 5 Pushimi ditor**

1. Punonjësit kanë të drejtë në pushim ditor midis dy (2) ditëve të njëpasnjëshme të punës në kohëzgjatje prej së paku dymbëdhjetë (12) orë pa ndërprerë.
2. Gjatë kohës së punës, në punët stimore, punëtori ka të drejtë pushimi nga paragrafi 1. i këtij neni, në kohëzgjatje prej së paku njëmbëdhjetë (11) orësh pandërprerë.

#### **Neni 6 Pushimi javor**

1. Punonjësit kanë të drejtë në pushim javor në kohëzgjatje prej së paku njëzetekatër (24) orë pandërprerë.
2. Nëse punonjësit i duhet të punojë në ditën e pushimit javor, atij duhet t'i sigurohet një ditë pushimi gjatë javës së ardhshme.

#### **Neni 7 Pushimi vjetor**

1. Punonjësit gjatë çdo viti kalendarik ka të drejtë për pushim vjetor të paguar në një kohëzgjatje prej së paku katër (4) javë kalendarike.
2. Zgjatja e pushimit vjetor përcaktohet varësisht nga stazhi i punës, ku për çdo pesë (5) vite të përvojës së punës, shtohet një ditë pune.
3. I punësuar i cili punon në punët dhe detyrat e punës për të cilat përkundër aplikimit të masave mbrojtëse nuk mund të mbrohet nga ndikimet e dëmshme, ka të drejtë në pushim vjetor në kohëzgjatje së paku prej tridhjetë (30) ditësh pune për vitin kalendarik.
4. Nënata me fëmijë deri në tri (3) vjeç si dhe prindi vetushqyes dhe personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë në pushim vjetor edhe për dy (2) ditë pune shtesë.
5. Ditët e pashfrytëzuara të pushimit vjetor nuk mund të kompensohen me para, përjashtimisht kjo mund të bëhet kur marrëdhënia e punës i skadon të punësuarit.
6. Çdo njësi e institucionit, në fillim të vitit kalendarik përgatit planin orientues të shfrytëzimit të pushimeve vjetore për punonjësit.

7. Plani orientues hartohet duke marrë parasysh kërkesat e punonjësve dhe nevojat e njësisë së institucionit.

8. Punonjësit nuk mund të heqin dorë nga e drejta e tyre për pushim vjetor, ndërsa pushimi shfrytëzohet brenda vitit kalendarik që fitohet.

9. Punonjësit mund t'i bartë në vitin tjetër maksimalisht dymbëdhjetë (12) ditë pune të pushimit vjetor të pashfrytëzuar. Ditët e pashfrytëzuara të pushimit vjetor duhet të shfrytëzohen brenda gjysmës së parë të vitit të ardhshëm kalendarik 30 (Qershor).

9. Punonjësi mund të kërkojë të marrë pushim vjetor në çfarëdo kohe gjatë vitit, pas miratimit të kërkesës nga udhëheqësi i tij. Mosmiratimi i kërkesës duhet të arsyetohet.

10. Punonjësit me orar të shkurtuar, shfrytëzojnë pushimin vjetor në mënyrë proporcionale me orët e punës.

## **Neni 8**

### **Orari i shfrytëzimit të pushimit vjetor**

1. Orarin e shfrytëzimit të pushimit vjetor e përcakton punëdhënësi në marrëveshje me punonjësin.

2. Me rastin e caktimit të orarit për shfrytëzimit e pushimit vjetor, punëdhënësi mund të marrë parasysh kërkesën dhe vullnetin e arsyeshëm të punonjësit.

3. Për intervalin kohor të shfrytëzimit të pushimit vjetor, punonjësi duhet ta njoftojë punëdhënësin më së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë para fillimit të shfrytëzimit të pushimit vjetor.

4. Me rastin e lejimit të pushimit vjetor, punonjësit i lëshohet vendim për orarin dhe kohëzgjatjen e pushimit vjetor më së paku pesë (5) ditë para fillimit të shfrytëzimit të pushimit vjetor.

5. Pushimi vjetor mund të shfrytëzohet në dy (2) apo më shumë pjesë, në marrëveshje me punëdhënësin.

6. Në qoftë se punonjësi e shfrytëzon në dy apo me shume pjesë pushimin vjetor, pjesa kryesore duhet të shfrytëzohet për së paku dhjetë (10) ditë pune të pandërprera gjatë një (1) vitit kalendarik..

## **Neni 9**

### **Pushimi vjetor në ditën e festave zyrtare**

1. Festat zyrtare që bien në ditë pune, sipas Ligjit për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës, nuk llogariten ditë të pushimit vjetor.

2. Nëse i punësuarit gjatë kohës së shfrytëzimit të pushimit vjetor sëmuret, koha e pushimit të lejuar mjekësor, nuk llogaritet në pushim vjetor.

## **Neni 10**

### **Pushimi vjetor për herë të parë**

1. Punonjësi i cili për herë të parë themelon marrëdhënie pune ose i cili nuk ka ndërprerje më tepër se pesë (5) ditë pune, fiton të drejtën për shfrytëzimin e pushimit vjetor pas gjashtë (6) muajsh të punës së pandërprerë, në proporcion me muajt e punuar.
2. Paaftësia e përkohshme për punë sipas dispozitave për sigurimin shëndetësor dhe mungesa me pagesë nga puna, si dhe në rast të mungesës së arsyeshme nga puna, nuk konsiderohen ndërprerje në punë, sipas paragrafit 1. të këtij neni.
3. Punonjësi nuk mund të heqë dorë nga e drejta e shfrytëzimit të pushimit vjetor.

## **Neni 11**

### **Pjesa e pushimit vjetor në përpjesëtim me kohën e kaluar në punë**

1. Punonjësi ka të drejtë, së paku një ditë e gjysmë (1.5) të pushimit, për çdo muaj kalendarik të kaluar në punë, nëse:
  - 1.1. në vitin kalendarik në të cilin për herë të parë ka themeluar marrëdhënie pune, nuk i ka gjashtë (6) muaj të punës së pandërprerë;
  - 1.2. në vitin kalendarik nuk e ka fituar të drejtën për shfrytëzimin e pushimit vjetor për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

## **Neni 12**

### **Kompensimi për mosshfrytëzimin e pushimit vjetor**

1. Punonjësit nuk mund t'i mohohet e drejta në shfrytëzimin e pushimit vjetor .
2. Punonjësi që nuk e ka shfrytëzuar pushimin vjetor apo një pjesë të pushimit me fajin e punëdhënësit, ka të drejtë për ta shfrytëzuar atë pushim gjatë periudhës vijuese e cila i konvenon punonjësit, apo kompensim me të holla.
3. Lartësia e kompensimit nga paragrafi 2. i këtij neni, caktohet varësisht nga kohëzgjatja e pushimit vjetor të pashfrytëzuar sipas të ardhurave të cilat i punësuari i realizon për muajin kur kompensohet.

## **Neni 13**

### **Procedurat për shfrytëzimin e pushimit vjetor**

- Punonjësit paraqesin kërkesë të udhëheqësi i tyre, së paku tri (3) ditë pune para fillimit të shfrytëzimit të pushimit vjetor, në pajtim me planin.
2. Kërkesa e miratuar nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë i dërgohet Shefit të Sektorit të personelit, për ta përfshirë në dosjen personale të nëpunësit.

## **Neni 14**

### **Pushimet për festa zyrtare**

1. Punonjësit gëzojnë të drejtën e pushimit në ditët e festave zyrtare, siç parashihet me ligj.
2. Sipas nevojave të institucionit, punonjësi mund t'i kërkohet të punojë edhe gjatë ditëve të festave zyrtare.
3. Ditët e punës për punonjësit gjatë festave zyrtare kompensohen sipas bazës ligjore.
4. Nëse festa zyrtare bie në ditë vikendi dhe me vendim të ministrisë përkatëse shtyhet në ditë pune, atëherë punonjësi do të kompensohet me ditë të lirë.

## **Neni 15**

### **Pushimet e veçanta**

1. Punonjësit kanë të drejtë në pushime të veçanta, të cilat janë:
  - 1.1. pushimi mjekësor;
  - 1.2. pushimi i përdëllimit;
  - 1.3. pushimi prindëror dhe
  - 1.4. pushimi pa pagesë.
- 1.5 Pushim për mbrojtjen e doktoratës deri 1 (një) muaj me pagesë me vendim për datën e mbrojtjes së temës.

## **Neni 16**

### **Pushimi mjekësor**

1. Punonjësi ka të drejtë në pushim mjekësor në kohëzgjatje prej 20 ditë pune brenda 1 (një) viti kalendarik me kompensim në rast të sëmundjeve dhe lëndimeve.
2. Në rast të përkeqësimit të përsëritur të gjendjes shëndetësore, nëse pushimi mjekësor shfrytëzohet në vazhdimësi, apo në periudhën e fundit 10 ditore, shërbyesi (publik) spitalor ka të drejtë në zgjatje të pushimit mjekësor edhe për 10 ditë të ardhshme.
3. Për sëmundje të rënda të anëtarëve të familjes së ngushtë të shërbyesit (publik) spitalor, të vërtetuara me raport, i takon mungesa prej 15 ditë me pagesë në emër të pushimit mjekësor.
4. Punonjësit që kryejnë punë me rrezikshmëri iu takon pushimi mjekësor prej 25 ditë pune me kompensim të plotë, duke shfrytëzuar edhe të drejtën sipas parag.2 të këtij neni.

## **Neni 17**

### **Pushimi mjekësor pa pagesë**

1. Pas skadimit të pushimit mjekësor me pagesë, punonjësit mund t'i vazhdohet pushimi mjekësor pa pagesë.
2. Nëse punonjësi ka nevojë për trajtim më të gjatë, sipas rekomandimit të komisionit mjekësor, udhëheqësi i drejtpërdrejtë mund të lejojë që të mungojë nga puna pa kompensim të pagës.

## **Neni 18**

### **Pushim me pagesë**

1. Pushimi i përdëllimit me pagesë jepet në ditë pune si në vijim:
  - 1.1. Pesë (5) ditë në rast të martesës;
  - 1.2. Tri (3) ditë për kurorëzim të fëmijëve ;
  - 1.3. Pesë (5) për lindje apo adoptim të fëmijës ;
  - 1.4. Pesë (5) ditë në rast të vdekjes të anëtarit të ngushtë të familjes;
  - 1.5. Pesë (5) ditë për vdekje të bashkëshortit ose fëmijës ;
  - 1.6. Pesë (5) ditë për vdekje të prindit të bashkëshorti ;
  - 1.7. Tri (3) ditë për vdekje të gjyshit ose të gjyshes;
  - 1.8. Tri (3) ditë për dhënie të provimit profesional ose të ndryshëm për nevojat e institucionit ;
  - 1.9. Tri (3) ditë për zhvendosje të familjes nga një vend në tjetër ;
  - 1.10. Tri (3) ditë për fatkeqësi elementare ;
  - 1.11. Një (1) ditë pune në çdo rast të dhënies vullnetare të gjakut.

## **Neni 19**

### **Pushimi prindëror**

1. Punonjësja gëzon të drejtën e pushimit të lehonisë prej dymbëdhjetë (12) muajsh.
2. Me prezantimin e certifikatës mjekësore, punonjësja mund ta fillojë pushimin e lehonisë deri në dyzetepesë (45) ditë, apo së paku njëzetetetë (28) ditë para datës kur pritet të lindë, me rekomandim specialistik mjekësor me kompensim si në vijim:
  - 2.1. Gjashtë (6) muajt e parë të pushimit të lehonisë, paguhet nga institucioni me kompensim 70% të pagës bazë të nëpunëses.
  - 2.2. Tre (3) muajt në vijim, paguhet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me kompensim 50% të pagës mesatare në Kosovë. Dhe
  - 2.3. Tre (3) muaj e tjerë, pa pagesë mund të merren me kërkesën e punonjësës.
3. Pushimin e lindjes sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, e gëzojnë edhe punonjëset me orar të shkurtuar.
4. Nëse punonjësja nuk dëshiron ta shfrytëzojë të drejtën në pushim të lehonisë nga nën paragrafët 2.2. dhe 2.3, të këtij neni, duhet ta njoftojë udhëheqësin e drejtpërdrejtë të saj, më së voni pesëmbëdhjetë (15) ditë para përfundimit të pushimit, nga nën paragrafi 2.1. i këtij neni.
5. Nëse punonjësja nuk e shfrytëzon pushimin nga nën paragrafi 2.2. i këtij neni, asaj mund t'i jepen pushim, dy (2) orë brenda orarit të punës dhe një (1) orë në ditë, nëse nuk e shfrytëzon të drejtën e përcaktuar me nën paragrafin 2.3.
6. Punonjësja me orar të shkurtuar të punës ka të drejtë t'i shfrytëzojë orët për dhënien gjë fëmijës proporcionalisht me numrit të orëve që ajo punon.
7. Babai i fëmijës mund të marrë të drejtat e nënës, nëse nëna vdes ose e braktis fëmijën para se të përfundojë pushimi i lehonisë.
8. Punonjësit kanë të drejtë në tri (3) ditë pushim atësie për lindjen e çdo fëmije. Me kërkesën e punonjësit, mund t'i jepet pushim plotësues i atësisë pa pagesë, më së shumti deri në katërmëdhjetë (14) ditë.
9. Të drejtat nga nën paragrafët 2.2. dhe 2.3. të këtij neni mund të barten te babai i fëmijës në marrëveshje me nënën.
10. Pushimi prindëror duhet të shfrytëzohet për qëllimin që jepet dhe nuk mund të akumulohet apo të shndërrohet në vlerë monetare.
11. Për çdo pushim prindëror të punonjësit institucioni merr vendim.

## **Neni 20**

### **Pushimi i prindëror për përkujdesje të veçantë apo humbje të fëmijës**

1. Fëmija i cili domosdo ka nevojë për përkujdesje të veçantë për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore, respektivisht fëmija i cili është me aftësi të kufizuara të përhershme, njëri prej prindërve, me skadimin e pushimit të lehonisë, ka të drejtë të punojë me gjysmë orari të punës derisa fëmija t'i mbushë dy (2) vjet.

2. Nëse punonjësja lind fëmijën e vdekur, apo fëmija i vdes para përfundimit të pushimit të lehonisë, sipas konstatimit të mjekut, ka të drejtë në pushim lehonie për aq kohë sa i nevojitet të këndellet nga lindja dhe gjendja psikike e shkaktuar nga humbja e fëmijës, por jo më pak se dyzetepesë (45) ditë pushim.

## **Neni 21**

### **Rikthimi në pozitën e mëparshme**

1. Punonjësja pas shfrytëzimit të pushimit të lehonisë, rikthehet në pozitën e mëparshme.

2. Nëse punonjësja ka qenë ushtruese e detyrës së një pozite para shkuarjes në pushim të lehonisë, nuk i ruhet pozita e ushtruesit të detyrës.

## **Neni 22**

### **Pushimi pa pagesë**

1. Pushimi pa pagesë mund të autorizohet në raste të veçanta nga udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit punëdhënës, si në vijim:

1.1. Për ngritjen profesionale për nevojat e vetë punonjësit.

1.2. Për kujdesin ndaj anëtarëve të ngushtë të familjes, për shkak të sëmundjes (bashkëshortit, bashkëshortes, prindit, fëmijës, motrës, vëllait);

1.3. Për kandidim për zgjedhjet komunale dhe qendrore;

1.4. Për transferim të përkohshëm në detyra të tjera brenda ose jashtë Kosovës;

1.5. Për marrjen e detyrës së funksionarit publik dhe

1.6. Për kryerjen e obligimeve ushtarake.

2. Pas kalimit të periudhës së pushimit pa pagesë, punonjësi e ruan të drejtën e kthimit në pozitën e mëparshme apo ekuivalente me të.

3. Punonjësi ka të drejtë në pushim pa pagesë kur:

1.1 punonjësi ka përvojë të punës 2 (dy) vite ka të drejtë pushim pa pagesë 6 (gjashtë) muaj,

1.2 punonjësi ka të drejtë kërkesë për herën e dytë pushim pa pagesë pas 5 (pesë) viteve punë me arsyetim përkatës.

## **Neni 23**

### **Procedurat e pushimit pa pagesë**

1. Kërkesa për pushim pa pagesë bëhet më shkrim, si dhe përmban qëllimin dhe periudhën e pushimit.

2. Kërkesa, pas rekomandimit nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë, i dorëzohet për shqyrtim dhe aprovim udhëheqësit më të lartë administrativ, i cili nxjerr vendim për këtë çështje.

3. Vendimi i udhëheqësit më të lartë administrativ i dërgohet Shefit të Sektorit të Personelit, për veprim të mëtutjeshëm me gjithë dokumentacionin e bashkangjitur kërkesës, dhe në rast të kërkesës për pushim pa pagesë për shkak të sëmundjes duhet ti bashkëngjitet dokumentacioni përkatës mjekësor.



**Neni 24**  
**Evidentimi i të dhënave për pushimet**

Shefi i Sektorit të Personelit njoftohet nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë për pushimet e punonjësve dhe është i obliguar t'i regjistrojë të dhënat në dosjet fizike dhe elektronike të punonjësve dhe t'i përmbledhë kopjet fizike të vërtetimeve përkatëse në dosjen personale.

**Neni 25**  
**Mungesa nga puna pa pagesë**

1. Në bazë të kërkesës së punonjësit, punëdhënësi mund të lejojë që punonjësi të mungojë nga puna pa kompensim të pagës me arsyetim dhe kohëzgjatje.
2. Për kohën e mungesës në punë pa kompensim të pagës nga paragrafi 1. i këtij neni, punonjësit i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, përveç të drejtave të cilat burojnë nga pagesa e detyrueshme e kontributeve nga punonjësi.

**Neni 26**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi pas aprovimit nga ana e Bordit Drejtues të SHSKUK-së.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

